



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data: 28.2.2025

Nr: 225

Ora: 12:00

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE PARTIA “ALEANCA EUROPIANE EKOLOGJIKE”, ME KRYETAR Z. SAZAN GURI, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË DATËS 11 MAJ 2025**

Sot, më datë 28.2.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën nr. 1334 prot., datë 25.2.2025, me:

**KËRKUES:** Partia politike Partia “Aleanca Europiane Ekologjike”, me kryetar Z. Sazan Guri

**OBJEKTI:** Regjistrimi i partisë politike Partia “Aleanca Europiane Ekologjike” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025

**BAZA LIGJORE:** Neni 64, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

**V Ë R E J:**

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025, për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

Partia “Aleanca Europiane Ekologjike”, nëpërmjet Kryetarit, Z. Sazan Guri, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend, që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Data: 28.2.2025 Nr: 225  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike Partia “Aleanca Europiane Ekologjike”, me Kryetar Z. Sazan Guri, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 4.12.2024, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia “Aleanca Europiane Ekologjike”, me initiale “AEE”, me Kryetar Z. Sazan Guri, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02)
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03)

Nga dokumentacioni si më sipër dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është: Partia “Aleanca Europiane Ekologjike”, me shkronja nistore “AEE”, me adresë: Rruga “Bardhok Biba”, Pll. 75, Shk. 2, Ap. 5, Kt. 1, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është: Z. Sazan Guri, me adresë: Rruga “Bardhok Biba”, Pll. 75, Shk. 2, Ap. 5, Kt. 1, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është: Z. Arbër Disha, me adresë: Rruga “Shefqet Kuka”, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në, është Z. Altin Goxhaj, me adresë: Rruga “Bardhok Biba”, Pll. 75, Shk. 2, Ap. 5, Kt. 1, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga Partia “Aleanca Europiane Ekologjike”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga Partia “Aleanca Europiane Ekologjike” është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.01.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 11 Maj 2025.

## V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike Partia “Aleanca Europiane Ekologjike”, me kryetar Z. Sazan Guri, me shkronjat nistore “AEE”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Illirjan CELIBASHI**